

AKT-THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“WATER BOUTIQUE Shpk ”

EMERTIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISE, SELIA E SHOQERISE, KOHEZGJATJA.

Ne baze te Ligjit nr.9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” si dhe te Ligjit Nr.9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”dhe statutit te shoqerise, me vullnetin e tyre te lire shprehur ne nenshkrimin e ketij akti, ortaket: **Zoti URIM VATA**, lindur me 01/06/1979, banues ne Tirane , me karte identiteti nr H90601200F, me shtetesi dhe kombesi shqiptare si dhe **XHENI VATA**, lindur me 15/10/1988, banues ne Tirane , me karte identiteti nr I86015046S, me shtetesi dhe kombesi shqiptare kane hartuar, si me poshte vijon ,aktin e themelimit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar.

Shoqeria krijohet dhe ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe vecanerisht me Ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, te Ligjit Nr.9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”aktet e tjera ligjore qe do te jene ne fuqi gjate veprimtarise se shoqerise, si dhe dispozitat e Statutit te shoqerise qe i bashkengjiten ketij Akti Themelimi.

Emertimi i shoqerise eshte “WATER BOUTIQUE ” SH.P.K.

SELIA E SHOQERISE.

Selia e shoqerise eshte ne TIRANE , ne adresen Rruga Nacionale Tirane - Durres , Peze e Vogel , Lagja “ Bilal “ godine 2 Kt , kati perdhe , N 1 .Shqipëri.

Veprimtaria e shoqerise ne tërë territorin e Republikës së Shqipërisë kryhet nga degët e saj, të cilat funksionojnë në rrethe apo ndarje të tjera administrative te Republikës së Shqipërisë nën drejtimin e Drejtorisë.


Shoqëria mund te çele degë dhe zyra përfaqesimi të reja jashtë territorit te Republikës se Shqipërisë. Ato hapen dhe prishen me vendim te të Asamblesë së Pergjithshme të saj.

Asambleja e Pergjithshme mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare te administratoreve të shoqerise, organizon punën, përcakton mënyrën e funksionimit dhe emëron organet drejtuese dhe përfaqësuesit e tyre ligjor.

JETEGJATESIA E SHOQERISE

Kohëzgjatja e shoqerise “**WATER BOUTIQUE**” SH.P.K. është pa afat te caktuar dhe ka filluar në momentin e regjistrimit të shoqerise në Qendren Kombetare te Regjistrimit Shkoder .

Ky afat mund të ndryshohet në çdo kohë me vendim të Asmblesë së Pergjithshme të Ortakëve me të njëjtin kuorum që përcakton ligji tregtar për ndryshimin e statutit.



Shoqëria mund të prishet gjyqësisht përpara këtij afati në rastet kur humbet kuptimi moral dhe ligjor i egzistencës së saj apo kur parashikohet shprehimisht në ligj, nëpërmjet kërkesës së çdo aksioneri drejtuar gjykatës.

Shoqëria mund të prishet edhe në rastin e humbjes së aktivitetit të pasurisë së saj deri në një vlerë sa gjysma e kapitalit aksionar. Në këtë rast zbatohen dispozitat Pjesa V "Shoqëritë Aksioneri", Titulli VII, "Prishja e Shoqërisë" të ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqëritë tregtare"

OBJEKTI I SHOQERISE

Objekti i shoqërisë në përputhje me legjislacionin aktual tregtar shqiptar do të jetë:

Import, Export .shitje me shumice dhe pakice te filtrave te ujit. Aparate për ndriçim, ngrohje, prodhim avulli, gatim, ftohje, tharje, ventilim, furnizim me ujë dhe qëllime sanitare. Aparate per filtrimin e ujit, Aparate dhe makineri per purifikimin e ujit, Impiante per shkripezimin e ujit, Aparate per distilimin e ujit, Instalime per shperndarjen e ujit, Instalime per furnizimin e ujit {te nxehte}, Instalime purifikuese per ujerat e zeza & derdhjeve te ujerave industriale {riciklimi}, Instalime vaditje automatike, (I0010) Makineri dhe aparate akulli. Transporti, paketimi dhe magazinimi i mallrave; përgatitje udhëtimi. Shpërndarja e ujit në shishe për përdorim shtëpiak dhe në zyra. Shërbime paketimi Përpunimi i materialeve Purifikimi i ujit dhe shërbimet e përpunimit si shkripëzimi, distilimi i ujit. Dhënia me qera e aparateve të purifikimit të ujit, Dhënia me qera e aksesoreve të filtrimit të ujit me qëllim tregtimi, Dhënia me qera e pajisjeve të përpunimit, Kontrolli i ndotjes së ujit, Përpunimi i mbetjeve të ujit që prodhohet nga instalimet gjenerike, Ripërpunimin e ujërave të zeza. Ripërpunimi i ujërave të shkarkimit. Mbajtja e mbledhjeve dhe seminareve TE HAPURA per te informuar, trajnuar, shqyrtimin dhe pergatitjen e analizave ndaj mjedisit dhe studimeve te bera .Laborator i pergjithshem per teste uji dhe studime te ndryshme per ndotjen dhe trajtimet e ujit.

KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali i shoqërisë është 100.000 (njqindmije) lekë dhe zoterohet nga ;

- 1 . Urim Vata zoteron 51% te vleres se aksioneve qe eshte 1 kuote.
2. Xheni Vata zoteron 49 % te vjeres se aksioneve.e eshet 1 kuote.

Depozitimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë është shlyer plotësisht nga ortaku në përpjestim me pjesët takuese në kapital.

Ndryshimi i kapitalit



Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet apo të zvoglohet vetëm me vendim të Ortakeve te, pra me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme kur shoqëria është me shume se nje ortak. Në çdo rast, ndryshimi i kapitalit të shoqërisë duhet të jetë i arsyetuar dhe i shoqëruar me relacionin e Ekspertit Kontabël të shoqërisë.

Ortakët ka të drejtën e perparësise për nënshkrimin e kuotave të shlyeshme në para që emetohen për zmadhimin e kapitalit. Kjo e drejtë është në përpjestim me shumën e kuotave të zotëruara nga ortaku përpara zmadhimit të kapitalit.

Ortakët mund të heqë dorë vetëm individualisht nga e drejta për nënshkrimin e kuotave të reja. Ato, gjithashtu, kanë të drejtë të kërkojnë nënshkrimin e një numri më të vogël kuotash nga sa i takon sipas parimit të përpjestueshmërisë, por me kusht që Asambleja të ketë vendosur shprehimisht për këtë gjë.

Procedurat për ndryshimin e kapitalit të shoqërisë duhet të fillojnë brenda tre muajsh nga dita e marrjes së vendimit sipas rastit, të Ortakut të vetëm si dhe të Asamblese së Përgjithshme, përndryshe janë të pavlefshme.

Brenda 3 vjetësh nga dita e kryerjes së ndryshimeve duhet të regjistrohet vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit.

ORGANET E SHOQERISE

Organet e shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakeve.
- Administratori.

Asambleja e Ortakeve është organi më i lartë i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar

“WATER BOUTIQUE”SH.P.K.

Nepermjet këtij emërohet administratori i shoqërisë Zotit **URIM VATA** të cilit i jepen të gjitha kompetencat, që ai i pranon, për të kryer të gjitha formalitetet për krijimin e shoqërisë, parashikuar sipas ligjit në fuqi.

Ortakët dhe administratori ushtrojnë të gjitha kompetencat, të drejtat dhe detyrimet për organizimin dhe drejtimin e shoqërisë, të cilat parashikohen nga ky statut, akti i themelimit dhe legjislacioni shqiptar, për të vepruar në emer dhe për llogari të shoqërisë, në përputhje me objektin e veprimtarisë së saj, me përjashtim të atyre kompetencave që ligji dhe ky statut ja njohin shprehimisht ortakeve.

Kompetencat e administratorit janë:

- Organizimi i veprimtarisë së shoqërisë për të plotësuar programin që buron nga objekti i veprimtarisë së saj.
- Administrimi i përgjithshëm i shoqërisë.
- Perfaqëson shoqërinë para autoriteteve gjyqësore, të arbitrit dhe administrative.
- Administron pasurinë dhe aktivet financiare të shoqërisë, brenda kufijve të caktuar nga ortakët.
- Të leshojë dokumente zyrtare në emer të shoqërisë për të punësuarit e shoqërisë dhe në përputhje me palet e treta.

Ushtrimi financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti. Përjashtimisht viti I parë financiar kur do të nisë veprimtaria e shoqërisë do të mbyllet më 31 Dhjetor.

Shoqeria e fillon aktivitetin ne momentin e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit TIRANE.

Përfaqësimi

Kufizimet e tagrave te perfaqesimit te administratoreve i kundrejtohen paleve te treta, ne përputhje me dispozitat e nenit 12 te Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008“Per tregtare e shoqerite tregtare”.

Administratoret, qe përfaqësojne bashkarisht shoqërinë tregtare, mund te autorizojne disa prej tyre per kryerjen e disa veprimeve te caktuara apo per kryerjen e disa kategorive te caktuara veprimesh. Njoftimet e drejtuara secilit prej administratoreve jane te vlefshme e detyruese per shoqerine.

Tagrat e perfaqesimit te administratoreve dhe cdo ndryshim i tyre njoftohen per regjistrim prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

Administratori i pare i shoqerise do te jete **Z.URIM VATA.**, me kohe zgjatje deri ne marrjen e nje vendimi tjeter te asamblese te shoqerise, por pa kaluar afatin maksimal prej 5-vjetesh i përcaktuar ne nenin 95 te Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008“Per tregtare e shoqerite tregtare”, me te drejte ripërteritje.

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen me ane te kontrates se punes. Per ceshtjet qe nuk rregullohen me kontraten e punes, zbatohen dispozitat e Kodit te Punes.


Ky akt-themelimi eshte hartuar ne Tirane, me 03/07/2018, ne pese ekzemplare duke patur te gjithë tekstet fuqi te barabarte.

**FIRMOSUR NGA
ORTAKET**

URIM VATA



XHENI VATA



VËRTETIM I NENSHKRIMIT

Sot me 05.07.2018 ne zyren e noterise TIRANE me seli ne adresen”
Bulevardi Bajram Curri “ , P 1 Maji, NO.34 , une notere AISHE AHMETAGA , u
paraqiten personalisht :

URIM AVDI VATA , lindur me 1.6.1979 Kukës banues ne Tirane rruga “ Besim Fagu “ Nr 38 Tirane dhe me
ID H90601200F

XHENI FIQRET VATA , datelindjes 15.10.1988 Korçë banues ne Tirane ne adresen e mesiperme ” dhe me
ID I86015046S

*Per identitetin e te cileve u sigurova mbi bazen e dokumentave te tyre personale
dhe pasi konstatova se i kane te gjitha aftesite e kerkuara nga ligji , vertetova
nenshkrimin e tyre ne akt themelim dhe statut te perpiluara jashte zyres sime noteriale
“ WATER BOUTIQUE SHPK “ , une noterja verteton nenshkrimet e tyre .*

NOTERE : AISHE AHMETAGA

